



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 4080/ Prot

Tiranë, më 17/11 /2021

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

**DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 34, datë 14.09.2020 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirim të detyra të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës” i ndryshuar dhe shkresës 6847 prot, datë 09.11.2021 “Njoftim për vend të lirë pune”, të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Tiranë, protokolluar në AKPA me nr.4090 prot, datë 12.11.2021, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në faqen elektronike zyrtare të AKPA-së si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë, brenda datës 19.11.2021, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- 1 Specialist në Sektorin e Zyrës Vendore Kavajë, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë.

1. Krite të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

2.Kritere të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit Bachelor,
- b) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit;
- c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

3. Dokumentet e aplikimit:

- a. letërmotivimi për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën nr. 1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 34, datë 14.09.2020 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me kodin e punës” i ndryshuar me udhëzimin nr.47, datë 31.12.2020;
- c. fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës
- d. fotokopje të librezës së punës (për kandidatët që janë ose kanë qenë në marrëdhënie pune);
- e. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (nëse ka);
- f. certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g. vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h. vërtetim të gjendjes gjyqësore (lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë)
- i. vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi (përfshihen ato që janë në proces gjyqësor por të dëshmuara) (për kandidatët që janë ose kanë qenë në marrëdhënie pune);
- j. Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm (për kandidatët që janë ose kanë qenë në marrëdhënie pune).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA-s, brenda datës 08.12.2021.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

